

Ndryshimet në Ligjin për Tatim në të Ardhura të Korportave

Sami Salihu – U.d. Drejtor i Departamentit për Regjistrim
dhe Shërbim të Tatimpaguesve

Shtator, 2019



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ndryshimet në Ligjin Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

Neni i Ligjit	Përshkrimi
Neni 2. Fushëveprimi:	Është shtuar nen i ri, sipas të cilit dispozitat e Ligjit për Tatim në të Ardhurat e Korporatave janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës dhe për të gjithë personat në fushëveprimin e Ligjit për Tatim në të Ardhurat e Korporatave.
Neni 3. Përkufizimeve ligjore:	Është bërë plotësimi dhe riformulimi i disa përkufizimeve ligjore me qëllim të sqarimeve dhe harmonizimit të termeve me të gjitha Ligjet tjera tatimore, si: Pasuri kapitale, Rezident, Njësia e Përhershme, Personat e lidhur, Furnizues, Transferi i çmimit, Transaksion i kontrolluar, Konsiderata, Provizionet teknike; Provizionet matematike; Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë, etj.



Neni 6. Të Ardhurat e tatueshme:

Te neni “Të Ardhurat e tatueshme”, në paragrafin 2 është fshirë nën paragrafi 2.1 lidhur me bizneset e licencuara nga BQK për të siguruar apo ri siguruar jetë, pasuri apo rreziqe tjera, ndërsa në këtë paragraf është shtuar nën paragrafi lidhur me të ardhurat bruto nga interesi. Po ashtu, është shtuar paragrafi 3 sipas të cilit për tatimpaguesin i cili nuk tatohet në të ardhura reale, të ardhura të tatueshme konsiderohen të ardhurat bruto. Gjithashtu, në këtë nen është shtuar edhe paragraf i ri sipas të cilit të ardhurat bruto nga interesi sipas paragrafit 2.3 të këtij neni nuk përfshijnë interesin nga mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë apo nga cilido fond tjetër pensional i përkufizuar sipas legjislacionit përkatës mbi kursimet pensionale në Kosovë.

Neni 7. Shkallët e tatimit:

Te neni “Shkallët e tatimit”, është fshirë paragrafi 2 që kishte të bëjë me Kompanitë e Sigurimit dhe tani sipas këtij Ligji Kompanitë e Sigurimit trajtohen sikurse çdo person tjetër juridik.

Neni 8. Të ardhurat e liruar:

Te neni “Të ardhurat e liruar” është riformuluar paragrafi lidhur me Pushimet tatimore për t’ju dhënë të drejtë të përfitojnë të gjitha bizneset pavarësisht a janë të reja apo jo, si dhe është shtuar paragraf i ri ku kërkohet që Ministri të nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.



Neni 9. Shpenzimet e palejueshme:

Te neni “Shpenzimet e palejueshme” është shtuar paragraf i ri, sipas të cilit të palejueshme janë shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion, përveç nëse kanë ndodhur në lidhje me afarizmin e tatimpaguesit që ofron aktivitetet për dëfrim dhe rekreacion.

Neni 10. Shpenzimet e lejueshme:

Te neni “Shpenzimet e lejueshme” është shtuar paragraf i ri sipas të cilit kërkohet që Ministri të nxjerr akt nënligjor për shpenzimet e dokumentuara të cilat rrjedhin nga vlerësimet/rivlerësimet doganore.

Neni 11. Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik

Në nenin “Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik” në paragrafin 1 është shtuar nën paragrafi 1.1. sipas të cilit kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L-090 për Sponzorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Pra, sipas Ligjit për Sponzorizimet:

- 1. Sponsorizuesit për sponsorizimet në aktivitetet e sportit u njihet zbritja tridhjetë përqind (30%) nga tatimi në fitim sipas këtij ligji.*
- 2. Sponsorizuesit në sponsorizimet në fushën e kulturës dhe rinisë u njihet zbritja njëzet përqind (20%) nga tatimi në fitim në bazë të Ligjit Nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.*

Neni 13. Shpenzimet e Borxhit të keq:

Te neni “Shpenzimet e Borxhit të keq” është fshirë paragrafi 4 dhe paragrafi 5 është bërë paragraf 4.



Neni 14. Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë dhe provizionet teknike dhe maNenitike

Neni “Fondi rezervë” është ndryshuar në tërësi në “Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë dhe provizionet teknike dhe maNenitike” dhe është si më poshtë:

1. Provizionet për humbjet e pritura nuk lejohen si shpenzime të zbritshme në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, përveç rasteve të parapara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të licencuara nga BQK, për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që të njohin shpenzime të zbritshme provizionet për humbjet e pritura nga kreditë deri në 80% (tetëdhjetë) përqind të shumës së përcaktuar me akt nënligjor të nxjerr nga BQK.
3. Institucionet Financiare të Sigurimeve dhe Risigurimeve, të licencuara nga BQK, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që t’iu njihen shpenzimet e zbritshme, provizionet për rezervat teknike dhe maNenitike, deri në 80% (tetëdhjetë) përqind të shumës së përcaktuar me Ligjin për Sigurimet dhe aktet nënligjore të nxjerr nga BQK.
4. Pas njohjes së provizioneve sipas paragrafit 2 të këtij neni, çdo shumë e zvogëluar nga mbledhja e kredive të provizionuara, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumat e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.
5. Pas njohjes së provizioneve teknike dhe maNenitike sipas paragrafit 3 të këtij neni, çdo shumë e zvogëluar nga provizionet, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumat e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.
6. Në rast se BQK kërkon korrigjim të provizioneve të deklaruara sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, ndryshimet e tilla duhet të rregullohen në deklaratë tatimore.
7. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.



Neni 16. Zhvlerësimi:

Te neni “Zhvlerësimi” është eliminuar paragrafi 7, i cili ka të bëjë me pasuritë kapitale të cilat janë blerë dhe kanë filluar të zhvlerësohen sipas metodës së grupimit para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-162 për Tatim në të Ardhurat e Korporatave, pasi që me Ligjin aktual për Tatim në të Ardhurat e Korporatave Nr. 05/L-029 nuk ekziston mundësia e grupimit të pasurive kapitale, por ato duhet të zhvlerëson individualisht. Po ashtu, te ky nen është eliminuar edhe paragrafi nr. 9, zhvlerësimi i pasurive grupore prej 1,000€ deri në 3,000€ të blera prej 1 janar 2010 e deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatim në të Ardhurat e Korporatave.

Neni 18. Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja:

Neni “Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja”, është riformuluar duke saktësuar se e zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Ndërsa zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë apo jashtë Kosovës. Po ashtu në këtë nen është shtuar edhe paragrafi 4, sipas të cilit zbritja e posaçme për pasuritë e reja nuk lejohet për personat të cilët përfitojnë nga pushimet tatimore dhe lehtësirat tjera të veçanta.

Neni 22. Fitimet dhe humbjet kapitale:

Te neni “Fitimet dhe humbjet kapitale” është fshirë paragrafi 7 ku fitimet dhe humbjet kapitale nuk pranohen për pasurinë e grupuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatim në të Ardhurat e Korporatave.



Neni 24. Humbjet Tatimore:

Te neni “Humbjet Tatimore”, është ndryshuar paragrafi 2 dhe humbja mund të bartet vetëm për 4 vite.

Neni 28. Transferi i çmimit:

Neni “Transferi i çmimit” është riformuluar në tërësi me qëllim që të jetë më i qartë dhe të jetë në harmoni me parimet e OECD-së ku është definuar se për përcaktimin e transferit të çmimit shfrytëzohen metodat tradicionale të transaksionit, si dhe në rrethana të caktuara tatimpaguesi mundet të zbatojë metodat tradicionale të fitimit.

Neni 29. Shmangia e Tatimeve të dyfishta:

Neni “Shmangia e Tatimeve të dyfishta” është riformuluar me qëllim që të jetë më i qartë dhe të jetë në harmoni me Modelin e OECD-së.

Neni 30. Njësia e Përhershme

Neni “Njësia e Përhershme” është riformuluar me qëllim të harmonizimit me Modelin e OECD-së.

Neni 31. Tatimi i mbajtur në burim në paga, pensione, interesi, të drejtat pronësore, qiratë, fitoret në lotari dhe lojërat e fatit:

Te neni “Tatimi i mbajtur në burim në paga, pensione, interesi, të drejtat pronësore, qiratë, fitoret në lotari dhe lojërat e fatit” është shtuar paragraf i ri ku është përfshirë mbajtja në burim edhe për pagesat e fitoreve të lotarisë dhe lojërave të fatit të bëra për persona fizik jo afarist. Po ashtu, në nën paragrafin 1.3 është fshirë pjesa e sigurimeve shëndetësore, ka qenë e pakuptim përfshirja e sigurimeve shëndetësore në këtë paragraf sipas Ligjit aktual Nr. 05/L-029 për Tatim në të Ardhurat e Korporatave.



Trajtimi i aktiviteve të sigurimit:

Neni "Trajtimi i aktiviteve të sigurimit" është fshirë në tërësi.

Neni 32. Tatimi i Mbajtur në Burim për Kategori të Veçanta:

Neni "Tatimi i Mbajtur në Burim për Kategori të Veçanta" gjegjësisht paragrafi 1 i këtij neni është riformuluar duke ndërruar normën nga 3% në 1%, si në vijim:

1. Çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej një përqind (1%) në bruto pagesë, në momentin e pagesës.

Neni 35. Kërkesat për Libra dhe Regjistrime:

Neni "Kërkesat për Libra dhe Regjistrime" është riformuluar ku është ndërruar limiti nga 50,000€ në 30,000€ me qëllim që të jetë në harmoni me limitin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Neni 36. Kërkesat për Libra dhe Regjistrime për bizneset e vogla:

Neni "Kërkesat për Libra dhe Regjistrime për bizneset e vogla" është riformuluar ku është ndërruar limiti nga 50,000€ në 30,000€ me qëllim që të jetë në harmoni me limitin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Neni 37. Deklarimi i tatimeve:

Neni "Deklarimi i tatimeve" është riformuluar në tërësi me qëllim që të jetë më i qartë dhe të jetë më lehtë i zbatueshëm, si dhe definon se kur duhet të dorëzohet deklarata vjetore në rastin e mbylljes së aktivitetit ekonomik.



Neni 38. Pagesa e tatimit:

Neni “Pagesa e tatimit” është riformuluar ku është ndërruar limiti nga 50,000€ në 30,000€ me qëllim që të jetë në harmoni me limitin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Po ashtu, paragrafi 6, nën paragrafi 6.2 është riformuluar me qëllim që parapagimi i tatimit të ketë mundësi në bartjen për shlyerjen e detyrimeve tatimore si në pagesa paradhënie apo edhe në cilindo lloj tatimi dhe kontribut pensional. Gjithashtu, edhe në nën paragrafin 5.1 është definuar se zbritje janë edhe shumat e mbajtura të tatimit në burim nga të tjerët dhe të paguara në ATK jo vetëm sipas Ligjit për TAK, por edhe sipas Ligjit për TAP.

Vëmendje:

Në përgjithësi në tërë Ligjin Nr. 05/-L-029 për Tatim në të Ardhurat e Korporatave, janë përmirësuar edhe gabime gjuhësore, si dhe janë bërë riformulime të disa paragrafëve me qëllim që të jenë qartë të kuptueshme.





Ju faleminderit për vëmendje!



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo